

KUVAJTI, NJË SHEMBULL I URTË I REAGIMIT NDAJ TË KEQES SË ORGANIZUAR!



FALËNDERIM PËR ZOTËRINË TONË, JUSUFIN (A.S)



NË NDERIM TË BIBLIOTE KËS SË MYFTIUT TË TABAKËVE APO KËLYÇI

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 21 - Nr. 7 (245), Korrik, 2023


www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Ju ftoj në Islam

"I kam hyrë studimit te Kur'anit pa ndonjë mendim paraprak dhe me objektivizëm, në kërkim të shkallës së përputhshmërisë së tekstit kur'anor me të dhënat e shkencës moderne. Arrita në konkluzionin se nuk ka asnjë thënie të kritikueshme nga pikëpamja shkencore bashkëkohore..."

- Maurice Bucaille -



MYFTIU PRITI STUDIUESIN E AFIRMUAR, Z. HAJRUDIN S. MUJA



(f. 17)

U ZHVILLUA EDICIONI I 11-TË I KONKURSIT TË MADH FETAR ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË ZONAVE ADMINISTRATIVE POSTRIBË DHE RRETHINA



(f. 15)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

KUVAJTI, NJË SHEMBULL I URTË I REAGIMIT NDAJ TË KEQES SË ORGANIZUAR!

Shkëputje hytbeje...

"Ishim në Haxh kur dëgjuam dhe ndoqëm lajmet për veprimin barabar të një mercenari jomysliman, diku në zemër të Stokholmit, që bënte një veprim të ulët,është në hak të muslimanëve, por që nuk është i vetmi në fakt!

Nuk është hera e parë, që në Evropë, në cepat e ndryshëm të saj, dalin këta çibanë të së keqes, për të dhunuar dhe për të prishur ekuilibrat e njerëzimit, edhe me mburojën e çuditshme dhe paradoksale të shteteve dhe qeverive që valëvisin flamurin e qytetërimit, të lirisë e të vlerave në këtë botë!?

Dita-ditës po bien gjethet mbuluese; hipokrizia dhe urrejtja gjenetike kundër Islamit dhe myslimanëve po del në pah për të hedhur poshtë pretendimet e pabaza, për të nxjerrë në të vërtetë fytyrën e shëmtuar të sistemeve perëndimore kundër Islamit, kundër myslimanëve, kundër njerëzimit!

Dhe, mjafton për të mos u zgjatur në këtë pikë, të shohim emrat e shteteve, që kanë refuzuar të miratojnë para pak ditësh rezolutën e OKB-së për të drejtat e njeriut, që dënon aktet e tilla terroriste dhe barbare, kundër Islamit, kundër muslimanëve, kundër shenjtërive!?

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Allahu i Madhëruar i shpërbleftë të gjithë ato vende islame, duke nisur nga qëndrimet dinjitare të Shejkhul-Islamit tonë, Shejkhul-Ez'herit, Imam Et-Tajib, i cili urdhëronte, që më e pakta punë dhe më e pakta vepër është bojkotimi i të gjitha produkteve, i tregtisë, i shitblerjes, i eksporteve dhe i importeve, me çdo vend në të cilin lejohet që të digjet Kur'ani i dy miliardë myslimanëve në botë.

Ky është një akt shumë i drejtë dhe shumë logjik.

Pastaj duhet të falënderomë me zemër, veprimin e urtë dhe largpamës të Shtetit të vogël, por me zemër të madhe të Kuvajtit, që me urdhër të kryeministrit të vendit, nisi botimi i 100 mijë kopjeve të Kur'anit me përkthimin e kuptimeve të tij në gjuhën suedeze.

Ne nuk na ndalon dhe nuk na step një veprim i ulët i një mercenari primitiv me mbështetje ndërkombëtare, përkundrazi! Një Kur'an digjet, qindra e mijëra kopje të Kur'anit shpërndahen gjithandej nëpër botë.

Një i gënjyer e djeg Kur'anin, atje në zemër të Evropës, me qindra-mijëra të krishterë evropian konvertohen dhe kthen në Islam, duke refuzuar barbarinë dhe duke parë me sytë e zemrës madhështinë dhe dritën e Kur'anit Famëlartë, pastërtinë, dinjitetin dhe krenarinë e Islamit, të jetuarit nën hijen e dashnisë së Allahut edhe të Pejgamberit (a.s)!

Ne nuk na step një anonim, qoftë në Suedi, qoftë në Francë, qoftë ndonjë prej honxhobonxhove, prej analistëve të kësaj toke dhe të këtij vendi, kur flasin kundër Kur'anit, duke bërë të plotdijshmin rreth Kur'anit, duke hedhur vnerë rreth Kur'anit! Jo!

Por, na ngrohë dhe themi: Zoti ynë, Ty të takon falënderimi: "Ndoshta e urreni diçka dhe ajo është e mirë për ju"..."

(Shkëputur nga hytbeja me temë: "Djegia e Kur'anit, përfundimi i Haxhit dhe fillimi i vitit të ri 1445 h.", e mbajtur në xhaminë e Parrucës, më 14 korrik 2023)



JU FTOJ NË ISLAM!

"I kam hyrë studimit te Kur'anit pa ndonjë mendim paraprak dhe me objektivizëm, në kërkim të shkallës së përputhshmërisë së tekstit kur'anor me të dhënat e shkencës moderne. Arrita në konkluzionin se nuk ka asnjë thënie të kritikueshme nga pikëpamja shkencore bashkëkohore..." - **Maurice Bucaille**

Djegia e Kur'anit në disa vende të Evropës, është injorancë primitive dhe terrorizëm racial i dënueshëm, që e kthen kontinentin në errësirat e mesjetës së tij. Gjynah për këtë realitet të shëmtuar!

Akte të dënueshme dhe frymëzim për të ndërtuar më shumë medrese, qendra të hivzit dhe nxitje për t'u kapur përherë e më shumë pas Librit të Shenjtë!

"I kam hyrë studimit te Kur'anit pa ndonjë mendim paraprak dhe me objektivizëm, në kërkim të shkallës së përputhshmërisë së tekstit kur'anor me të dhënat e shkencës moderne. Arrita në konkluzionin se nuk ka asnjë thënie të kritikueshme nga pikëpamja shkencore bashkëkohore...", shkruante *Maurice Bucaille.*

Ndërsa misionari indian *Beshir Ahmed Shad*, reflekton: "Pyetja që më ka stresuar përherë është se ne, të krishterët, pretendojmë se Islami është përhapur me tehun e shpatës. Dhe e pyeta veten se, përse atëherë njerëzit e pranojnë Islamin dhe vazhdojnë ta përqafojnë atë, në çdo cep të botës? Përse njerëz nga mbarë bota udhëzohen drejt kësaj feje çdo ditë dhe pa asnjë kërcënim, dhunë a të ngjashme?"

E, ndërmjet islamofobisë së verbër në mesin e të paditurve në perëndim, dritësimit të intelektualëve dhe kthjellimit të misionarëve në raport me Kur'anin dhe Islamin, unë me zemër dhe me shumë sinqeritet ju ftoj në Islam!

Ju garantoj se do fitoni vetveten; në këtë dhe në të përtejmen!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 31 korrik 2023





Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

"Nuk ka si libri! Thesar i heshtur, mik, që nuk të pret në besë, këshillues pa interes, frymëzim pa faturë, motivues korrekt, nxitës drejt thellimit përherë e më shumë në hapësirat e pamatura të detajeve të dijes, urtësisë dhe eksperiencave që na shërbejnë në jetë, por jo vetëm!

Mos u ndani nga librat dhe bota e tyre! Mos e ndani librin nga jeta juaj!"

FALËNDERIM PËR ZOTËRINË TONË, JUSUFIN (A.S)



Dr. Salahudin Keftaro
Damask, Siri

Falënderim për zotërinë tonë, Jusufin (a.s).

1- Falënderim për zotërinë tonë, Jusufin, prej tregimit të së cilit mësova se disa njerëz na urrejnë për shkak të cilësive të mira dhe jo për shkak të të metave tona...

Të urryen, sepse ti ishe: I bukur, i mirë, nuk u ngjaje atyre.

Dhe, njerëzit nuk e duan atë, i cili ua kujton të metat e tyre!

2 - Mësova, se nganjëherë goditja të vjen nga nuk e pret, dhe se ti kur shpëtove nga ujku, nuk arrite të shpëtoje nga vëllezërit tuaj!

3 - Mësova të mos ua tregoj të gjithëve çdo të mirë, që Allahu ma ka dhuruar, sepse disa, sytë e tyre i kanë të ngushtë, ndërsa zemrat edhe më të ngushta!

Shikojnë atë, që është në duart e të tjerëve, më shumë se sa shikojnë atë, që është në duart e tyre.

4 - Mësova, se keqbërësit nganjëherë veshin rrobat e këshilluesve;

Iblisi (shejtani) i ka thënë babait tënd, Ademit, qëmoti: "A të të tregoj për pemën e përjetësisë!"

Dhe, vëllezërit tuaj, i thanë babait tënd, Jakubit: "Ne jemi për të këshillues!", "Ne jemi për të mbrojtës!"

5 - Disa të këqija janë më të lehta, se sa disa të tjera..., dhe se njerëzit, ashtu siç dallojnë në mirësinë (hajrin) e tyre, dallojnë edhe në të keqen (sherrin) e tyre. Të shpëtoi vëllai me të keqen më të vogël, kur tha: "Mos e vrisni Jusufin!"

6 - Mësova të mos qaj për frikën time, në mënyrë që të mos më luftojnë njerëzit përmes saj, duke ditur se babai yt tha: "Kam frikë, se mos e ha ujku!" dhe vëllezërit tuaj i thanë, se të ka ngrënë ujku!

7 - Mësova, se nuk ka krim të plotë dhe, se kriminelit i ndodhin disa gjërat të vogla, të cilat i ka harruar dhe nuk i ka vënë re. Vëllezërit tuaj harruan të ta grisin këmishën.

Çfarë ujku është ai, që e gjuan prenë e tij, fëmijën, dhe këmisha i mbetet e pa shqyer (e pa grisur)!

8 - Mësova, se e mira (hajri) dhe e keqja (sherri) nuk është te gjërat, por në rrugën e përdorimit të tyre!

Këmisha jote një herë ishte mjet gënjimit; një herë tjetër ishte mjet i pafajësisë; dhe një herë tjetër ishte mjet shërimi!

9 - Mësova, se kjo botë nuk ka mirësi (hajr) në të; sa e keqe është ajo botë, në të cilën ti shitesh dhe blihesh për disa dirhem të paktë!

10 - Mësova, se shkollat, universitetet dhe librat nuk janë, veçse sebepe (shkaqe), dhe se mësuesi i vërtetë Ai është Allahu: "Për t'i mësuar atij nga komentimi i ëndrrave!", "I dhamë gjykim dhe dituri!"

Dhe, se Allahu e dhuron diturinë, aq sa është devotshmëria: "Kijeni frikë Allahun, dhe Allahu ju mëson" dhe se problemi nuk ka qenë ndonjë ditë, problem mendjeje, por problem zemre!

11 - Falënderim për zotërinë tonë, Jusufin, prej tregimit të tij mësova, se bujari nuk tradhton, dhe se i liri nuk e kthen të mirën me të keqe; dhe se fisniku nuk pështymë në burimin, prej të cilit ka pirë.

Sa e bukur është, ndërkohë që ti thua: "Allahu na ruajt, Ai është Zoti im, që më ka bërë strehim të mirë!"

12 - Mësova, se i pagabueshëm është ai, të cilin Allahu e ka mbrojtur prej gabueshmërisë dhe se të sprovuarit janë ata, të cilit Allahu i ka lënë në epshet e tyre; dhe se kush është me Allahun në bollëkun e tij, Allahu është me të në vështirësinë e tij!

13 - Siç mësova, se bota mbarë nuk mund të më detyrojnë të bëj, atë që nuk dua të bëj. U ndalova së arsyetuari të rrethanave dhe situatave! Gruaja e Azizit (ministrit) ishte zonja (skllavopronarja) jote, t'i mbylli dyert dhe të sulmoi. Tek ajo ishte bashkuar: Bukuria, pushteti dhe dëshira; por ti rezistove, sepse ti nuk doje!

14 - Mësova, se Allahu nëse do të shfaqë diçka, tërë njerëzit mbarë nuk mund ta mbulojnë atë gjë.

15 - Falënderim për zotërinë tonë, Jusufin, prej tregimit të tij mësova, se në burg ka viktima të shumtë (njerëz të pafajshëm që u është bërë zullum) dhe se, njerëzit mund të hyjnë në burg si ndëshkim të mos veprimit të tyre të gjynahut, dhe se zullumi është i hershëm në mesin e njerëzve.

16 - Mësova, se ëmbëlsia e besimit (imanit) e mundë ithtësinë e jetës; dhe se ëmbëlsia e besimit të bëri të harrosh ithtësinë e burgut dhe se, nëse ti do të tradhtoje, mos e dhashtë Allahu ta bësh një gjë të tillë, atëherë pallati (kështjella) me tërë gjerësinë e tij, do të të ishte ngushtuar.

17 - Mësova, se çdo vend të jep mundësinë e thirrjes (davetit), skllav në pallat (kështjellë) bëre thirrje për tek Allahu; i burgosur në burg bëre thirrje për tek Allahu; i nderuar në fronin e sundimit bëre thirrje për tek Allahu.

18 - Mësova, se njeriu i fisshëm, atë nuk e ndryshon asnjë vend. Në burg të thanë: "Ne të shohim se je prej bamirësve!", dhe në fronin e sundimit kërkuan prej teje falje, sepse ata të panë se ti je prej bamirësve.

19 - Falënderim për zotërinë tonë, Jusufin, prej tregimit tënd mësova se, hasreti (smira) është pas çdo të keqe (sherri). Ai është gjynahu i parë, me të cilën i bënë gjynah Allahut në qiell. Iblisi (shejtani) nuk refuzoi t'i bëjë sexhde (t'i përulet) Ademit, veçse nga hasreti (smira); dhe ky është gjynahu i parë, me të cilin i bënë gjynah Allahut në tokë. Kabili nuk e vrau vëllanë e tij (Habilin), veçse nga hasreti (smira); dhe se nuk të hodhën në pus, veçse nga hasreti (smira)!

20 - Mësova, se fesadi (prishja), në shumicën e rasteve, është prej menaxhimit (administrimit) të keq, jo prej burimeve të pakta, dhe se ti, kur i shpëtove banorët e Egjiptit nga thatësira, nuk u solle atyre burime të reja, por me mentalitet menaxhimi (administrimit) të ri të burimeve të vjetra.

21 - Mësova, se dynjaja është luftë e ndezur mes të vërtetës (hakut) dhe të kotës (batilit), nuk pushon deri në ditën e kiametit. Ushtarët, vetëm ata janë, të cilët ndryshojnë; konflikti yt me gruan e Azitit (ministrit) është konflikt dëlirësie dhe epshi në çdo vend; dhe konflikti yt me vëllezërit tuaj është konflikt dashurie dhe urrejtjeje në çdo vend.

22 - Mësova të planifikoj, të mirë administroj dhe se njerëzit nuk arrijnë nevojat (qëllimet) e tyre, veçse përmes planifikimit dhe mirë administrimit. Për thatësirën kishe planin dhe mirë administrimin, dhe për mbajtjen e vëllait tënd te ti, kishe planin dhe mirë administrimin!

23 - Mësova, se Allahu gjithmonë zgjedh për betejën armën, që nuk i shkon mendja askujt; ishte i Plotfuqishëm të dërgojë melekë për të shembur muret e burgut e të të nxirrte jashtë, por Ai dërgoj një ëndërr te mbreti!

24 - Mësova, se postet janë përgjegjësi, e jo nderim; dhe, se nuk i kërkove depot e tokës, për t'i pasur në posedim, por për t'i shpërndarë; e sikur të dije, se dikush tjetër është më i aftë se ti, nuk do t'i kishe kërkuar!

25 - Mësove, se dashuria është rehati (qetësi), që nuk e njeh, veçse të dashuruarit, për këtë, babai jot e nuhati erën tënde, përpara se t'i mbërrijë këmisha jote!

26 - Falënderim për zotërinë tonë, Jusufin, prej tregimit tënd mësova të mos i ankohem për dëshpërimin dhe hidhërimin tim, veçse Allahut; sepse njerëzit, ose janë që të të duan, ose që të të urrejnë. Ai që më do, do të hidhërohet për hatër tim, ndërsa ai që më urren do të gëzohet prej meje, e të dy nuk zotërojnë asgjë prej dëshpërimit tim; atëherë përse të mos i ankohem për dëshpërimin tim Atij, që në dorën e Tij është e tërë çështja?!

27 - Falënderim për zotërinë tonë, Jusufin, prej tregimit të tij mësova të injoroj, që të qëndroj i dashur dhe të sillem (veproj) sikur unë nuk kam kuptuar gjë, që t'i mbajë lidhjet, ndërkohë që në veten tënde e mbajte të fshehur, edhe pse kishe mundësi të mos e bëje, por fisniku i injoron (anashkalon) gjërat; arabët kanë thënë: Zotëria i njerëzve është ai, që bën gjoja se nuk di!

O Zoti ynë, na jep mbarësi në atë, që Ti e do dhe je i kënaqur me të!

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

XHAMI NË NJË PREJ ZONAVE MONUMENTALE TË NJOHURA TË LONDRËS

Pas 3 vitesh refuzim dhe presion, miliarderi mysliman britanik arrin të marrë lejen për të hapur xhaminë dhe Qendrën Islame brenda zonë më të rëndësishme historike monumentale të Londrës.

Çfarë di për të?

XHAMI NË NJË PREJ ZONAVE MONUMENTALE TË NJOHURA TË LONDRËS

Miliarderi britanik nxjerr lejen për hapjen e xhamisë dhe Qendrës Islame brenda zonës rekreative (çlodhëse) monumentale më aristokrate në zemër të Londrës pas disa viteve refuzimi.

KUSH ËSHTË ASIF AZIZ?

Ka lindur në Malawi të Afrikës, pastaj ka emigruar i vogël së bashku me familjen e tij.

U bë prej njerëzve të njohur biznesmenë në Britani - 56 vjeç.

U bë i njohur me pseudonimin 'Mr. West End', si tregues i zonës, në të cilën janë të përqendruara investimet dhe pronat e tij.

Në vitin 2020, Azizi kërkoi leje për ndërtimin e xhamisë për 9 mijë vende falleje.

Por shkaku i presioneve të të djathtës ekstreme, këshilli i qytetit të Westminster-t e refuzoi kërkesën.

Së fundmi, pas 3 vitesh, në maj 2023, erdhi miratimi dhe Azizi e nxori lejen për hapjen e xhamisë, që do të zë 390 vende falleje.



CILI ËSHTË KOMPLEKSI HISTORIK TROCADERO?

Ndërtesa historike ka kaluar nëpër disa ndryshime:

Nga sallë muzikore në vitin 1882, në sallë kërcimi në vitin 1965.

Pastaj, kompleks rekreativ (çlodhës), duke përfshirë hotel dhe disa restorante, derisa e bleu Azizi në vitin 2005.

Fondacioni "Aziz i bamirësisë' do të marrë përsipër shndërrimin e katit të poshtëm në xhami dhe Qendër Islame dhe do të quhet 'Piccadilly Prayer Square' (Sheshi i Namazit Piccadilly).

- Marrë nga TRT Arabic -

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja



NË NDERIM TË BIBLIOTEKËS SË MYFTIUT TË TABAKËVE APO KËLLYÇI

- Histori, kulturë, trashëgimi, gjurmë dhe mosharresë... -



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Biblioteka e Myftiut të Tabakëve apo Këllyçi është një nga më të vjetrat në Shkodër, ndonëse për një bibliotekë termi "i vjetër" sikur nuk shkon dhe aq, duke ditur që libri nuk njeh moshë, ai përcjellë vlerë, kulturë, dituri, jetë, ekzistencë dhe rrezatim dijetarësh...

Sipas të dhënave, mendohet, të jetë themeluar nga fillimi i shekullit 19-të. E, duke rendur në gjurmët e historisë së kësaj Biblioteke, u ndala në një shkrim të botuar në revistën "Përpjekja Shqiptare", që u botua por nuk qarkulloi në vitin 1938, u rishtyp në Tiranë, në vitin 1941. (F. Fishta: Biblioteka e Myftis së Tabakëvet në Shkodër, në "Shkëndija", Tiranë, vj. II, korrik 1941, nr. 1, f. 15 - 17)

Shkrimin mund ta krahasoj me një dritë, si atëhere edhe sot, pavarësisht dramave dhe historive të dhimbshme të kësaj Biblioteke, ajo ende dritëson qiellin e kulturës shqiptare. Duke e parë me vëmendje shkrimin, dua të ndalem në disa momente, që për nga mënyra e përshkrimit, të argumentit, të faktit, të thellësisë së mendimit; vizioni intelektual e dituror mbetet parësor dhe dëshmi.

1.

"... Krijuesi i kësaj Bibliotheke asht Myftija i njohtun i Tabakëvet..."

2.

"Përmbi Myftin e Tabakëve ende sot, mbas njij kohe së gjatë, rrëfehen shum ndodhje, të cilat na apin të kuptojmë mbi shquetsin e tij të posaçme, sa të tërhjeki deri vetë nderimin e kryeqytetit t'ish perendoris otomane. Thonë se Stambolli i drejtohej për këshill Myftis së Tabakëve sa herë qi e shihte nevojen në lidhje me çashtje problematike qi i paraqiteshin n'interpretimin e sa problemeve besimtare. Populli i jonë aty këtu ende sot e kujton emnin e Myftis së Tabakëvet, vdekë para njij kavaljeti (shënim: shekulli). Shtoj tue diftue për të se, i pyetun dikur ky Myfti "u jepte fetfa" çashtjeve të shum-llojshëme".

3.

"... n'at Bibliothekë ka dorëshkrime Shqipe, të shkrueme me alfabetin vjetër Turqisht. Janë po ato lloj shkrimesh Shqipe me alfabetin Turqisht, të çilat i ka pasë përmend Gl. Elezoviqi në nji artikull të vetin n'Arhiv-in, organin e Seminarit Shqiptar t'Univers. të Beogradit (vj. 1924, lib. II, fl. I, fq. 133) përkëthim Shqip i Kaside-s së njohtun të Behlul Danës, vëllaut të Halifit të Bagdatit Harun - ur - rashid-it."

4.

Rrëfimi i z. Esat Myftia, sipas dorëshkrimeve të gjyshit të tij

"Shtëpija ku ndodhet Bibliotheka e Myftis së Tabakëvet asht nji nga ndërtesat tipike të Shkodrës: me oborr të madh para shtëpis. Kjo ndertesë e vjeter asht dy katësh [...] Librat e shtypun si edhe dorëshkrimet, gjithsejt afër tremij



blejsh, ishin të mbajtun përgjithsisht mirë, gati të gjith të lidhun në kartuç. Disa nga dorëshkrimet ishin shkruem prej njij kaligrafi t'ushtruem, sa me i kujtuem njeriut disa nga dorëshkrimet e bibliothekave të mdha t'Europës prendimore". I njajti përshkrues i parë i Bibliotekës së Tabakut apo Këllyçi, mbas 21 vjetësh me 11.10.1959 vizitoi për herën e dytë Bibliotekën në fjalë. Atë e gjeti po në gjendjen e vendin e maparëshëm. U fol mbi vizitën, të çilën një orientalist prof. universiteti, i kishte pasë ba Bibliotekës së mbipërmendun, mbi mejtimin që pat dhanë për te dhe, si qellim kryesor vizite, u bisedua mbi shenimet për 13 pashallarët turq të shek. XIX në Shkodër..."

5.

Shënimi nga dora e Isuf Tabakut, që u transkriptua me alfabetin latin nga Et'hem dhe Shefik Osmani:

"Data 1290. Në këtë vjet me 8 të muejit Qannuni Evvel (shënim: dhjetor) ditën e dielle, n'orën 8 alaturka xhephaneja që ishte në Kala të Shkodrës, mori flakë. Prej nji rrufeje që shkrepi në miniçjon, u ba krejt zhari shtëpia e ime, mbrenda së çilës mbaroi gjithçka. Unë edhe djali im pështuem, pesë vetë tjerë u banë hi e pluhun n'atë zjarr [...]. Sëbashku me teshat e shtëpisë, e shumta e libravet më mbaruen...".

6.

Rrëfimi i Shefik Osmanit lidhur me djegien e Bibliotekës

"Biblioteka, kishte libra në gjuhë të ndryshme, kryesisht arabe, perse dhe turke. Në bazë t'inventarit të kësaj biblioteke, lanë nga Isuf Tabaku, biblioteka kishte rreth 2000 vëllime dhe që ishin tefsirë, libra teologjikë, filozofikë, gjykime (shënim: fetfa) drejtësie e tjera. Asht interesant të kujtohet se, përveç librave të shtypun, në këte bibliotekë ka pasë edhe dorëshkrime të ndryshme, si p.sh. dorëshkrimi "Vehbie" i Tahir Gjakovës, njohtë nën emnin Tahir efendia i madh. Asht edhe një libër tjetër ku janë ba shënime të ndryshme historike mbi qeverimin e disa pashallarëve tjerë. Aty gjindeshin dy tahtet astronomike të Hoxha Tahsimit, i cili i botoi në Paris në 1284 (hixhiri)."

7.

Një shënim me interes nga Prof. Dr. Jup Kastrati

"Biblioteka e Tabakut nuk ka qenë, këtu, ku asht sot, por afër Urës së Bahçallëkut. Shtëpia ndodhej nën Kala, afër xhepehanes turke."

8.

Z. Esat Myftia rrëfen për djegien e Bibliotekës

"Prej kësaj biblioteke kanë teprue vetëm tre libra, për arësye se tjerët që shpëtuen nga zjarri, ranë në lumin që shkonte për bri shtëpisë dhe humben si krypa n'ujët. [... ...] Dy faqet e murit (të dhomës karakteristike me minerlleqe), janë të mbushura me qitabe. Ka gjithësejt dhetë syza: pesë në njenë anë dhe pesë në tjetrën. Çdo syzë asht afro pesë metër e gjatë, e ndame në mes, dhe larg (nalt) njena tjetrës 40 - 50 cm. Librat nuk janë të rregulluem mirë, në



kambë, si zakonisht, por një mbë shoq. Biblioteka, si ç'asht sot, ka nja dy mijë vëllime, formatesh së ndryshme, të medhenj e të vegjel. Shumica e tyne janë të lidhun në kartuç , në gjendje të mirë dhe, pothuejse te gjithë, me etiketat përkatëse.

Në këtë numër përfshihen librat e shtypun dhe dorëshkrimet, shumica e të cilavet janë të kopjueme me dorë nga vetë Isuf Tabaku dhe të lidhuna po prej tij. Arësyesja e të shkruemit me dorë ishte se vepra vinte në Shqipni, në një kopje dhe atëhere gjyshit iu donte, patjetër, për detyrën që kishte ta bante një punë këso dore kaq të mundëshme, pse libri i nevojitej orë e ças nepër duer edhe origjinali nuk i lihej veç për një kohë relativisht të shkurtë. Ky ishte dhe shkaku që gjyshi rrinte me nga gjashtë muej pa ardhë në shtëpi, ndonëse, medrezeja, ku hante, flinte dhe studionte nuk ishte fort larg shtëpisë."

9.

Inventari i shkruar nga dora e Isuf Tabakut

"Sëbashku me librat ruhet edhe inventari i shkruem nga vetë Isuf Tabaku. Asht i lidhun dhe ka 45 fletë formati të madh, ndër të cilat 34 janë të shkrueme, 10 të bardha për të vazhdue së shenjuemi veprat që do të shtoheshin dhe një faqe në fund përmban emnat e atyne që i kanë marrë librat hua. Inventari përfshin vepra arabisht, persisht dhe turqisht të ndame simbas landëvet. Këto, diku-diku, i ka nda edhe simbas auktorëvet, diku jo. Në bazë të këtij inventari biblioteka ka në gjirin e vet libra ditunish së ndryshme, të cilët, arrijnë në një numër rendor titujsh deri në njëzeteshtatë. Në mes të tyne përmendim vepra: teologjie, filozofie, drejtësie, gjuhësie, historie, gjeografie, shkenash matematike, fizike, kimie, astronomie, etj. [... ...]"

Libri i dorëshkrimeve t'Isuf Tabakut, në të cilin autori ka bërë shënime të ndryshme, në formë kronologjie dhe komentari. Brenda tij përfshihen shumë ngjarje me rëndësi historike. Herë-herë tregon edhe ndonjë ngjarje me rrezatim vetjak. Diku faqet e shkruara i përngjasin një vepre autobiografike. Diku shndrisin përshtypjet për librat, për pëlqimet ndaj tyresi rrjedhojë e leximit. E pse jo ka aty-këtu edhe ndonjë shënim kritik. Diku ka shënime treguese e njohëse se kush e ka hartuar librin. Diku jep informacion për jetën e autorit. Dhe libri i dorëshkrimeve, nga ana e konceptit, struktuës dhe përpilimit të kujton apo të ngjason me kronikat e latinëve, të mesjetës... të...

10.

Biblioteka, sa e moçme aq edhe dëshmuese rrëfen, përsëri, diturisht...

Brenda atyre dorëshkrimeve tregohet edhe për lidhjet e ngushta që Isuf Tabaku ka pasur me Kosovën, Tiranën, Elbasanin... etj. Brenda atyre dorëshkrimeve gjenden dhe shumë korrespondenca me njerëz të shquar të këtyre qyteteve, duke na përforcuar besimin tonë se në bibliotekë gjendeshin plot thesare të çmuara që i përkisnin njohjes së historisë, vlerave të vendit ku jetojmë, si dhe dimensionit kulturor që ka Shkodra, vendliondja jonë. Studiuesit tregojnë se në bibliotekë gjendeshin dorëshkrime të vlerta, si: "Tekfije-Vehbije" e vitit 1832 nga Tahir Gjakova; "Arnautçe elifbe" (Abece shqip, shtyp në Stamboll në vitin 1900); dy tahte (shënim: tabela astronomike) të dijetarit dhe patriotit të shquar Hoxha Tahsinit (1811 - 1881); fletë me shënime nga Isuf Tabaku për pashallarët turq që erdhën në Shqipëri; fletë ku janë të gdhendura edhe këto emra: Vuçiternë, Gjakovë, Shkodër, Konispol... etj. Fletë e fletë dorëshkrimesh që flet historia...

11.

BIBLIOTEKA...

Teksa prej kohësh po mblidhja fakte për Bibliotekën e Myftiut të Tabakëve apo Këllyçi, më sillej parasysh Lavdia e kësaj Biblioteke, më sillej dhimbja e padurueshme ku mendoja djegien dhe ridjegien e saj, ardhjen e mjegullës ogurzezë, të pluhurit të heshtjes; mendoja për Diturinë shumëdimensionale, personazhet lavdiplotë që lanë gjurmë, trashëgimin e pasur të qytetit tim që e puth parreshtur... E shumëçka mendoja, edhe pse loti më pikonte në faqe!.. E, që të mos mendoj më për harresën, po i drejtohem Kujtesës, të cilën nuk mund ta asgjësojë askush: as nata, as pluhuri, as dashakeqësit, as dhémohuarit..., as... Biblioteka e Myftiut të Tabakëve apo Këllyçi jeton!..

"KLINIKA E LIBRIT" NË TÜRKIYE, NJË NGA NJË I RIKTHEN DORËSHKRIMET E RRALLA

Ekspertët e Institucionit të Dorëshkrimeve të Türkiyes në librarinë Sami në Istanbul po u japin jetë të re librave të rrallë islamikë.

Mençuria shekullore shtrihet në tavolina të rreshtuara krah për krah në këtë ndërtesë historike. Bibliosmia – aroma e mykur e librave dhe dorëshkrimeve të vjetra – varet rëndë në ajër.

Këto faqet e kërrusura dhe të dëmtuara nga moti janë të grupeve të ekspertëve të angazhuar në një nga punët më të mundimshme dhe delikate – restaurimin e dorëshkrimeve dhe librave të dëmtuar.

Të gjitha janë shumë të rralla, disa janë të vjetra mijëravjeçare. Dhe të gjithë ato janë tepër të çmuara.

Në librarinë Rami të Stambollit – e inauguruar në fillim të vitit 2023 – dorëshkrimeve të vjetra dhe veprave të rralla të shtypura po u jepet një frymë e re nga Sifahane, që përkthehet "Klinika e librave", nën Institucionin e Dorëshkrimeve të Türkiyes. Biblioteka është vendosur në një ndërtesë të shekullit të 18-të dhe është përdorur si një kazermë ushtarake më parë. Kreu i Spitalit të Librave, Dr. Nil Baydar thotë për TRT World pse puna që ata bëjnë është sikur një ndërhyrje kirurgjikale.

"Konservimi është një profesion si mjekësia. Shëndeti i dorëshkrimit është elementi më thelbësor", thotë Baydar. "Puna kryhet në një mënyrë që nuk i prish ata, por i ruan... kjo bëhet në përputhje me standardet globale."



I themeluar në vitin 2010, Institucioni i Dorëshkrimeve të Türkiyes ndodhet në Stamboll, por ka edhe zyra në Ankara dhe Konia.

PROJEKT SHUMËKOMBËSH, SHUMËGJUHËSH

Ndër dorëshkrimet dhe librat e sjellë këtu për restaurim janë nga biblioteka të ndryshme dorëshkrimesh që punojnë nën institucionin dhe muzetë në gjithë Türkiyen, veçanërisht nga Istanbuli.

Përveç turqishtes osmane, arabe dhe persiane, në Bibliotekën Rami po restaurohen libra në gjuhë të tjera si hebraishtja dhe rusishtja.

Kombe të tjera – përfshirë Libanin – dërgojnë gjithashtu dorëshkrime për t'u restauruar në Sifahane, e cila gjithashtu merr punë restauruese nga Biblioteka Süleymaniye, një nga depot më të mëdha në botë të dorëshkrimeve islame.

Sifahane është gjithashtu ndër më të mirët në Evropë për sa u përket numrit të profesionistëve – me një ekip prej deri në 80 ekspertë, duke përfshirë inxhinierë kimikë, kimistë dhe biologë. Ai përdor gjithashtu teknologjinë më të fundit në restaurimin e librave.

Ekspertët në bibliotekë thanë se këtu janë restauruar kopje shumë të rralla të Kuranit të Shenjtë që datojnë në periudhat e hershme të Islamit.

Një nga librat e rrallë të restauruar ishte *'Kitab al-'llal wa-ma'rifat al-rijal'*, një libër 1.069-vjeçar mbi shkencën e Hadithit nga juristi dhe teologu mysliman me ndikim Ahmed ibën Hanbel. Biblioteka Süleymaniye ka të vetmen kopje të librit që ekziston në botë.

SI BËHET?

Restaurimi dhe konservimi është një punë e mundimshme, thonë ekspertët në Sifahane për TRT World, duke dhënë detaje të procesit që shkon për të ruajtur çdo faqe.

Dorëshkrimet – të bëra nga materiale organike si letra, lëkura dhe pergamena – dëmtohen me kalimin e kohës për arsye të ndryshme, duke përfshirë lagështinë, rritjen e kërpudhave, insektet dhe vjetrimin natyral.



Pas një dokumentacioni të detajuar, detyra e parë e ekspertëve është pastrimi – heqja e pluhurit, papastërtive, vajit dhe njollave në dorëshkrime.

Duke punuar në mjedisin e kontrolluar të bibliotekës ku rregullohet temperatura, ekspertët aplikojnë ngjitës natyralë të përgatitur posaçërisht me niseshte gruri mbi grisjet e imëta në dorëshkrime.

Më pas, në këtë zonë ngjitet dhe shtypet letër japoneze e punuar me dorë me trashësi të përshtatshme. I njëjti proces përsëritet në anën tjetër të letrës. Faqet që janë restauruar bashkohen më vonë së bashku në formë libri. Ndonjëherë, puna për një libër të vetëm mund të marrë muaj.

"Ka shumë faktorë që shkatërrojnë artefaktet", thotë Baydar, i cili ka disa vjet që punon në institucion.

"Materialet organike vjetrohen natyrshëm me kalimin e kohës. Pastaj ka edhe një faktorë të jashtëm. Ata që lexojnë librat mund të mos jenë gjithmonë të ndjeshëm (dhe të kujdesshëm). Një nga ekspertët, Mebrure Ipek Yuksel thotë se procesi i restaurimit fillon me dokumentacionin, "që është faza më e rëndësishme" kur ata mësojnë për materialin dhe teknikën e përdorur për të shkruar.

Ajo thotë se kërkojnë ndihmë dhe mësojnë nga kolegët e tyre më me përvojë ndërsa vazhdojnë punën e tyre.

"Kjo është një punë e kënaqshme. Ka dorëshkrime që i përfundova për 15 ditë dhe gjithashtu një dorëshrkim më mori dy vjet kohë", tha Yuksel për TRT World ndërsa punon në një faqe për të rregulluar vrimat e shkaktuara nga insektet.

Ekspertët zbulojnë gjithashtu se rregullimi i "riparimeve të vjetra nga trajtimet e mëparshme" të bëra në të kaluarën është gjithashtu pjesë e punës në Sifahane.

"Studimet profesionale të konservimit në Türkiye filluan në vitin 2012 kur u krijua Instituti i Dorëshkrimeve të Türkiyes", thotë Baydar.

"Në fakt, disa punë filluan në vitet 1950-ta, por ato nuk ishin shumë profesionale. Sigurisht, teknologjia ka përparuar. Gjithashtu, buxheti i ndarë për këtë punë është rritur gjithashtu. Prandaj, përgjegjësitë tona janë më të mëdha tani."

(www.trtbalkan.com)

"BISHTI I QENIT LËVIZ MË SHUMË SE KOKA E TË ZOTIT!"

Kur'ani Famëlartë, i vetmi Libër i shenjtë, origjinal dhe i paprekur nga dora tekanjoze e kujtdo në botë, do të vazhdojë të përhapet e të përhapet, derisa të gjithë të shohin se ai është E VËRTETA!

"Bishti i qenit lëviz më shumë se koka e të zotit!", është adapt për terroristin mercenar të krishterë, që sërish ka abuzuar me Kur'anin në një shtet racist, diku në Skandinavi.

Armiqësi e lashtë, urrejtje në gen, që nuk mbulohen me asnjë lloj hipokrizie dhe shfaqjesh të dala boje!

Asgjë e veçantë, në zamallahinë që ka pushtuar botën e intrigave dhe armiqësive shekullore kundër Islamit dhe muslimanëve, sidomos në këto kohë, kur Islami përhapet në mënyrë të mrekullueshme në perëndim, ndër joarabë!

Asgjë e veçantë, prandaj shijojeni mrekullinë e Islamit dhe ngrihuni me krenari e bindje, ta përhapim në çdo cep të vendit tonë dhe kudo që të jemi, që të hutuarit e të gënjyerit të shpëtojnë në këtë botë dhe në të përtejmen!

Nuk ka dyshim se, ai burrë i madh, për ardhjen e të cilit lutej Hz. Ibrahimi (a.s), për ardhjen e të cilit jepte sihariq Hz. Isai, i biri i Merjemes, dhe të cilit, Zoti i gjithësisë i thoshte: "Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është i shuar!", do të përhapet drita e Thirrjes së tij, përtej dëshirës së femohuesve idhujtarë!

Kur'ani Famëlartë, i vetmi Libër i shenjtë, origjinal dhe i paprekur nga dora tekanjoze e kujtdo në botë, do të vazhdojë të përhapet e të përhapet, derisa të gjithë të shohin se ai është E VËRTETA! Sepse Allahu i Madhëruar, që na e ka dëshmuar këtë në Fjalën e Tij, është Zoti Një, i Vërteti, pa shok e ortak, as dy e as tre!

Elhamdulilah për udhëzimin në Islam!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër

e xhumaja e parë e muajit të shenjtë Muharrem 1445.



KABARDINO-BALKARIA
REPUBLIKA KABARDINO-BALKARIANE

Kabardino-Balkaria, zyrtarisht Republika Kabardino-Balkariane, është një republikë anëtare e Federatës Ruse që gjendet në Rusinë jugperëndimore, në krahun verior të vargmalit të Kaukazit të Madh, dhe kufizohet me Stavropol-Krai në veri, Osetinë e Veriut në lindje, Gjeorgjinë në jug, dhe Karaçaj-Çerkezia në perëndim.

Vendi ka një sipërfaqe prej 12.500 km2 dhe një popullsi prej 903,000 banorësh (2023).

Kryeqyteti i vendit është **Nalçik.**

GJEOGRAFIA

Malet zënë gjysmën e territorit të republikës.

Republika Kabardino-Balkariane ndahet në tre rajone kryesore. Në jug është Kaukazi i Madh, kreshta e të cilit formon kufirin jugor të vendit. Katër vargmale: Glavni, Peredovoi, Skalisti dhe Çorni, shtrihen paralelisht. Majat më të larta në vend janë Elbrus (5,642 metra) dhe Dikh-Tau (5,204 metra). Mali Elbrus përfaqëson majën më të lartë të Evropës. Ky mal është i mbuluar me borë gjatë gjithë vitit, dhe prej tij ushqehen tre lumenj: Baksan, Malka dhe Kuban.

Në zonën malore të vendit, në përgjithësi, gjenden sipërfaqe të mëdha akullnajash, nga të cilat burojnë lumenj me rrjedhje të shpejtë.

Rajoni i dytë përfaqësohet nga zonat poshtë fushave të akullit, ku ndodhen livadhet alpine, pyjet halore dhe pyjet gjetherënëse (të përbëra nga ahu, lisi, alderi, shkoza, panja, frashri dhe plepi). Në veri të vargmaleve gjenden ultësira që arrijnë 500–700 metra lartësi. Në to gjenden pyje gjetherënëse, si edhe livadhe që zënë pjesën më të madhe të tyre.

Rajoni i tretë (në veri dhe verilindje) është rrafshina e Kabardinit, një territor i shtruar, i drejtë, në të cilin lumi Terek takohet dhe bashkohet me lumenjtë Çerek, Çegem, Baksan dhe Malka. Në perëndim dhe në lindje të lumit Terek gjenden fushat Bolshaja dhe Malaja, të cilat janë toka të pasura që përgjithësisht kultivohen.

KIMA

Klima përgjithësisht kontinentale ndryshon në varësi të relievit, nga kontinentale në ultësira, e deri në subalpine dhe subarktike në male. Temperaturat mesatare të Janarit variojnë ndërmjet –4°C (në ultësira) dhe –11°C(në male), kurse temperaturat mesatare të Korrikut shkojnë ndërmjet +23°C (në ultësira) dhe +4°C(në male).

EKONOMIA

Kabardino-Balkaria është e pasur me molibden, tungsten, qymyr, plumb, kallaj, bakër, hekur, ar, arsenik, antimon, qymyr të murrmë, naftë, fosfor, gur gëlqeror, merlit, gips dhe argjilë. Ekonomia e këtij vendi mbështetet



në mënyrë të konsiderueshme në prodhimin industrial, kryesisht në nxjerrjen e xeheve, përpunimin e metaleve dhe ndërtimin e makinerive.

Prodhimi përfshin pajisje për nxjerrjen e naftës, lloje të ndryshme elektro-kabllosh, vegla diamanti, lëkurë artificiale dhe materiale filmike. Prodhimi është i përqendruar kryesisht në qendrat industriale në rajonet Nalçik, Tirniauz, Prokhladnij, Terskij, Baksanskij dhe Majskij.

Ekonomia e republikës mbështetet shumë në bujqësi, veçanërisht në rajonet veriore. Kulturat kryesore atje janë gruri, meli, misri dhe patatet. Vreshtaria dhe pemëtaria (molla, dardha, pjeshka dhe kajsia) konsiderohen gjithashtu industri të rëndësishme. Kulturat kryesore industriale përfshijnë luledielli dhe kërpin. Industria e blegtorisë atje, përfshin prodhimtarinë e qumështit dhe mishit, mbarështimin e deleve, rritjen e shpendëve dhe mbarështimin e kuajve.

GJUHA

Kabardianët flasin kabardianisht, një gjuhë e Kaukazit veriperëndimor, dialekt i së cilës është edhe çerkezishtja. Balkarianët flasin gjuhën Balkar, e cila është një gjuhë turke, praktikisht identike me gjuhën Karaçaj. Megjithatë, të gjithë banorët e Republikës Kabardino-Balkariane flasin rrjedhshëm gjuhën ruse.

Gjuha zyrtare e Kabardino-Balkaria është rusishtja, gjuha Kabardiane dhe ajo Karaçaj-Balkar.

FEJA

Sipas një sondazhi të vitit 2012, 70.8% e popullsisë së Kabardino-Balkarisë i përkasin Islamit, 11.6% Kishës Ortodokse Ruse, 3,8% janë të krishterë, kurse pjesa e mbetur janë të besimeve të tjera.

HISTORI

Ashtu si me pjesët e tjera të Kaukazit, zona që tani njihet si Kabardino-Balkaria ka qenë e banuar prej mijëra vitesh. Kjo dëshmohet nga varret e lashta pranë qytetit Nalçik, të cilat studiuesit ia atribuojnë mijëvjeçarit të parë dhe të 2-të para erës sonë.

Origjina e banorëve të Kabardino-Balkaria-s është e lidhur thellësisht me republikat fqinje, Adigea dhe Karaçaj-Çerkesia. Fiset Adige filluan të quheshin Kabardianë për nder të udhëheqësit të tyre Kabarda. Sipas një versioni tjetër, kombi e ka marrë emrin e tij për shkak të grykave të thella të lumit Laba, në të cilat kanë qenë krijuar vendbanimet e para. Kështu, nga bashkimi i dy fjalëve "karba-dei", u formua "Karbadia", që do të thotë "banorët e poligoneve".

Balkarianët kanë qenë pjesë e rajonit Alania, dhe njëri nga fiset Vainakh, të cilët u ndikuan nga kultura turke pas pushtimit Mongol të ultësirave ku banonin fiset Nakh, dhe adoptuan gjuhën e tyre. Gjithashtu, nga ana gjenetike, ata janë të lidhur ngushtë me çeçenët dhe ingushët.

Mes viteve 1242 - 1295, rajoni ra nën kontrollin e mongolëve, pastaj nga vitet 1295 – 1427 kaloi në duart e gjeorgjianëve, kur u përfshi në një mbretëri të unifikuar çerkeze, dhe mbeti pjesë e asaj mbretërie deri në vdekjen e mbretit Inal (1453). Më pas rajoni mbeti i pavarur deri diku mes viteve 1769 – 1830, kur u zhvillua lufta ruso-çerkeze dhe ndodhi gjenocidi i mëvonshëm. Në këtë kohë rajoni ra nën pushtimin rus dhe u aneksua përfundimisht nga Rusia.

Kabardia fitoi pavarësinë për një kohë të shkurtër midis viteve 1739 - 1774, përpara se të aneksohej nga Rusia sipas Traktatit të Kyçyk Kajnarxha. Balkaria u aneksua nga Rusia në vitin 1827. Rusët krijuan një sërë fortesash, veçanërisht në Nalçik (kryeqyteti i sotëm i republikës), për të siguruar kontrollin e tyre mbi rajon. Një numër i konsiderueshëm rusësh - shumë me prejardhje kozake - u vendosën të banonin atje gjithashtu. Gjatë Luftës Civile Ruse, rajoni u bë pjesë e Lidhjes Juglindore Antikomuniste (1917–1918), dhe më pas, në vitin 1921,iu bashkua Republikës Autonome Popullore Malore. Më 1 shtator të vitit 1921, me shfaqjen e Bashkimit Sovjetik, territori u organizua


Kryeqyteti, Nalçik

në "Rajonin Autonom të Kabardinit". Vitin që pasoi, emri i rajonit u ndryshua në "Rajoni Autonom Kabardino-Balkar", dhe më 5 dhjetor të vitit 1936, u ngrit në status dhe u emërtua "Republika Socialiste Sovjetike Autonome Kabardino-Balkariane".

Në vitin 1944, udhëheqësi sovjetik i atëhershëm, Josif Stalin, i akuzoi në mënyrë të padrejtë Balkarianët për bashkëpunim me Gjermaninë naziste dhe e dëboi nga atdheu i tyre të gjithë këtë popullsi. Më 8 mars të vitit 1944 filloi deportimi i detyruar i tyre për në Kirgistan dhe Kazakistan. Njerëzit u dëbuan nga shtëpitë e tyre pa u lejuar të marrin me vete asnjë pasuri, u futën në vagonë me nga 50 persona, dhe u dërguan në zona të thella të vendit.

Kushtet çnjerëzore gjatë zhvendosjes shkaktuan vdekjen e 562 personave, por edhe më shumë njerëz vdiqën në mërgim, në trojet e reja ku ishin


Xhamia qendrore, Nalçik

vendosur dhe ku shiheshin si armiq të popullit. Krahas asgjësimit fizik, një dëm i madh iu shkaktua zhvillimit të kulturës kombëtare dhe sferëssë zhvillimit intelektual të këtyre njerëzve të dëbuar. Gjatë kësaj kohe, emri i tyre u fshi nga emërtimi, dhe Republika Socialiste Sovjetike Autonome Kabardino-Balkariane u riemërua si "Republika Socialiste Sovjetike Autonome Kabardine". Popullsia Balkare u lejua të kthehej në atdhe vetëm në vitin 1957 (pas vdekjes të Stalinit), dhe emërtimi i republikës që ekzistonte paraluftës, u rikthye.


Kabardino-Balkaria u bë një republikë e plotë në vitin 1991, dhe në Mars të vitit 1992 hyri në radhët e republikave të Federatës Ruse.

SI ERDHI ISLAMI NË KABARDINO-BALKARIA

Kaukazi është i famshëm për diversitetin dhe origjinalitetin e popujve të tij. Për sa i përket përhapjes së Islamit në mesin e këtyre popujve (disa i konsiderojnë si një grup i vetëm etnik), fillimi i këtij procesi lidhet me dy data,dhe me një kohështrirje prej më shumë se gjysmë mijëvjeçari.

Nga njëra anë, janë të njohura mbishkrimet në gjuhën arabe të shekujve 11-12, në Arkhiz (vendbanim në Republikën Karaçaj – Çerkezi), përfshirë edhe ato në gurët e varreve. Në këtë vend shkrimet arabe gjenden së bashku me monumentet epigrafike greke. Ekziston një mendim se në periudhën para-mongole kryeqyteti i Alanisë Kaukaziane ndodhej në këtë zonë. Mbishkrimet në gjuhën arabe shërbejnë si konfirmim shtesë i pranisë së grupeve muslimane midis alanëve.

12



Kryeqyteti, Nalçik

Në të njëjtën kohë, në mesin e Karaçajve dhe Balkarëve është i njohur emri i personit që tregohet nga legjendat si predikuesi i parë i Islamit mes këtyre popujve, dhe ai ishte Ajsandir Dudalani, i njohur ndryshe si Sheikh Abdullah Bukharaçi, një aristokrat vendas i Karaçaj-t (rreth viteve 1620 - 1735). Në mesin e Karaçajve dhe Balkarianëve, popujve Adige dhe Osetianëve, dhe madje edhe më herët në Hordhinë e Artë, Islami në fazat fillestare të përhapjes së tij ishte privilegji i fisnikërisë. Por gradualisht, ai u përhap edhe në shtresat e ulëta të shoqërisë, gjë e cila u lehtësua, ndër të tjera, nga lufta kaukaziane.

Derbent-i (Dagestani) konsiderohet të jetë rajoni ku Islami depërtoi më së pari në Kaukazin e Veriut. Më pas, Islami depërtoi te Kabardianët dhe Balkarianët, si nga Dagestani, ashtu edhe nga Hordhia e Artë, përmes rajonit të Vollgës së Poshtme. Forcimi i pozitës së Islamit në Kabarda u mundësua edhe nga “khanët e Krimesë, të cilët kishin marrëdhënie të shpeshta dhe të ngushta me malësorët ...”.

Islami në Kabarda u stabilizua plotësisht në shekullin e 18-të. Nga gjysma e parë e shekullit të 18-të, vetëm një pjesë e kabardianëve ishin myslimanë. Në fillim, Islami depërtoi kryesisht në mesin e fisnikërisë, pjesa tjetër e popullsisë e pranoi atë disi më vonë. Gjysma e dytë e shekullit të 18-të karakterizohet nga intensifikimi i procesit të islamizimit të të gjithë shoqërisë kabardiane, gjë e cila ndodhi kryesisht për shkak të acarimit të marrëdhënieve ruso-turke. Gjatë kësaj periudhe, thirrësit fetarë e zgjeruan veprimtarinë e tyre në Kabarda, duke predikuar jo vetëm ide fetare, por edhe politike. “Në Kabarda, Islami filloi të dominojë krishterimin për shkak të orientimit të tij politik me ngjyra të ndezura.

Përhapja e Islamit në Kabarda, është e lidhur gjithashtu - si në të gjithë Kaukazin e Veriut - me luftën kundër Rusisë kristiane-koloniale. Si predikuesit më të shquar të Islamit në rajon njihen Princi Adil-Girej Atazhukin dhe Mullah Iskhak Abukov.

Në Balkaria Islami depërtoi vonë. Deri vonë besohej se Islami filloi të përhapet në mesin e Balkarëve nga shekulli i 18-të, por hulumtimet e fundit sugjerojnë se është përhapur që nga shekulli i 17-të. Disa të dhëna dëshmojnë për depërtimin e predikuesve myslimanë në këtë rajon gjatë kohës së kalifatit arab dhe Hordhisë së Artë. Jeta shpirtërore e balkarëve para ardhjes së Islamit ishte një simbiozë komplekse e mbetjeve të ideve të krishtera dhe një sistem i adhurimit pagan.

Nga fillimi i shekullit të 19-të, Kabardianët dhe Balkarianët, si popujt e tjerë të Kaukazit të Veriut (me përjashtim të disa Osetianëve), deklaruan se i përkisnin Islamit sunit. Përhapja e Islamit atje ndodhi kryesisht në mënyrë paqësore, dhe zuri vend gradualisht, duke iu përshtatur traditave e zakoneve lokale, ligjit zakonor (adeteve) dhe strukturës shoqërore të shoqërisë Kabardiane dhe Balkariane.

Me përhapjen e Islamit u forcuan pozitat e klerit dhe u rrit ndikimi e roli i tyre në jetën publike. Në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të dhe nga fillimi i shekullit të 20-të, Islami në Kabarda dhe Balkaria u zhvillua në thellësi. U ndërtuan xhami të reja, në të cilat filluan të funksionojnë medresetë. Në to studentëve u mësohej leximi i Kur'anit dhe shkrimi arab. Islami kontribuoi në zhvillimin e shkrim-leximit dhe në formimin gradual të kulturës së shkruar të Kabardianëve dhe Balkarianëve.

Me vendosjen e pushtetit sovjetik, shteti filloi të zbatojë një politikë të çrrënjosjes së çdo feje. Në fund të viteve 20, kleri mysliman në Kaukazin e Veriut dhe në Kabardino-Balkaria (rajon me popullsi 90% myslimane), u ndalua nga kryerja e funksioneve te tij (regjistrimi i lindjeve, martesave, vdekjeve... adhurimi, arsimi, procedimi ligjor), dhe funksionet e tij iu transferuan organeve përkatëse shtetërore. Kështu ndodhi një ndryshim i traditës fetare në këtë rajon. Në vitet 30-të, represionet kundër klerit mysliman u intensifikuan deri në arrestime, internime dhe shkatërrime fizike. Populli Balkarian e përkufizoi këtë periudhë kohore si “një kohë trazirash”, dhe e quajti atë si “koha e mërgimit të klerit”. Politika e ateizmit të detyruar vazhdoi deri në mesin e viteve 1980.

Në fund të viteve'80-të dhe në fillim të viteve 90-të, jeta fetare në Bashkimin Sovjetik ndryshoi rrënjësisht, gjë që u shoqërua me krijimin e një kuadri të ri legjislativ në vend në fushën e lirisë së mendimit dhe të veprimtarive të shoqatave fetare. Në shoqëri filloi të flitet shumë për besimin dhe fenë. Nga fundi i viteve 80-të, në bazë të të dhënave statistikore, në Kabardino-Balkaria u vu re një zhvillim i madhi ndërgjegjësimit fetar islam. Gjatë periudhës mes viteve 1990-2000 u ndërtuan rreth 100 xhami, kryesisht me shpenzimet e besimtarëve. Ndihma financiare u dhanë edhe nga vendet arabe dhe nga Turqia. Deri në vitin 2007, në Kabardino-Balkaria u vunë në funksion 132 xhami, ndërkohë që në këtë kohë 5 ishin në ndërtim e sipër. Xhami u ndërtuan në pothuajse të gjitha fshatrat e republikës, madje disa fshatra u bënë me disa xhami: me nga një xhami të madhe dhe me disa xhami të vogla lagjesh.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://en.wikipedia.org
http://v2.travelark.org
https://old.bigenc.ru
https://etokavkaz.ru
https://dumrf.ru
https://www.britannica.com

A LEJOHET DHURIMI I LEXIMIT TË KUR'ANIT PËR TË VDEKURIN?

Shejkh Abduselam Esh-Shuvejir

Cili është vendimi për hatmet e Kur'anit?

Nëse lexohet Kur'ani, shpërblimi i tij është për lexuesin apo për të vdekurin?

Ju kam thënë dje...

Mendimi i shumicës së dijetarëve... është se lejohet dhurimi i sevapit (shpërblimit) për të vdekurin.

Ky është mendimi i Imam Ahmedittë cilën e ka thënë në shumë mesele... rreth saj ka përmbledhur një kapitull Hal'laliky është edhe mendimi i Imam Malikut dhe mendimi i Imam Ebu Hanifesdhe Shejkh.

Takijudin ka një libërth... për vërtetimin se për të vdekurin lejohet t'i dhurohet sevapi (shpërblimi) për të... edhe Shejkh Ibn Tejmije, të cilën e ka pasuar edhe Ibnul-Kajimi rreth kësaj gjëje.

Shafitë e kanë refuzuar këtë gjë.



Kështu që, i lejohet dikujt ta lexojë Kur'anin dhe sevapin t'ia dhurojë babit të tijapo nënës së tij, për të vdekurin dhe për të gjallin lejohet gjithashtu.

Duke u bazuar te kjo... për të vdekurin lejohet të lexohet Kur'ani dhe sevapi t'i dhurohet atij...

Ky është mendimi i shumicës së njerëzve të dijes, përveç Imam Shafiut (Allahu e mëshiroftë)

VENDIMI I BASHKIMIT TË KËMBËVE NË NAMAZ ME NJËRI-TJETRIN

Rijad El-Isa - *Studiues islam*

Shejkh Abdullah ibn Fevzan në librin e tij "Minhatul-alam sherh bulugul-meram", f. 324, e ka sqaruar vendimin për këtë mesele dhe ndalimin e saj, duke thënë:

Për sa i përket bashkimit të këmbëve me njëri-tjetrin, siç veprojnë disa, kjo gjë:

- Në të ka shqetësim për të tjerët.

- Me të zënë veten dhe të tjerët me diçka, që nuk është legjitimuar, ka shtim të lëvizjeve dhe angazhim (të panevojshëm) pas ngritjes prej sexhdes për të mbushur boshllëkun.

- Përmes saj angazhon personin, i cili falet përkrah teje, që të bashkojë këmbën e tij me të tënden.

- Në të ka edhe zgjerim të hapësirës, dhe kjo vihet re kur personi bie në sexhde.

- Në të ka edhe ndërprerje të vendit të këmbës së tjetrit, pa të drejtë.



Dhe, nuk ka argument për këtë në hadithin e Enesit (r.a): "Ishim, që i bashkonim shpatullat (supet) dhe këmbët me njëri-tjetrin"; dhe në hadithin e En-Nu'man ibn Beshir (r.a): "E shikoje personin, që bashkonte shpatullat (supet) e tij me shpatullën (supin) e shokut të tij, gjurin e tij me gjurin e shokut të tij dhe këmbën e tij me këmbën e tjetrin", sepse qëllimi me këtë është - siç e ka treguar edhe El-Hafidh ibn Haxher - hiperbolizimi në drejtimin e safit (rreshtit), plotësimit të hapësirave dhe afrimit me njëri-tjetrit.

Me argumentin, se: Bashkimi i gjurit me njëri-tjetrin është i pamundur, bashkimi i shpatullave (supeve) është ngarkesë e panevojshme dhe gjithashtu edhe për bashkimin e këmbëve me njëri-tjetrin, e njëjta gjë.

Allahu e di më së miri!

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

NË QENDRËN KULTURORE OBLIKË PËRFUNDOI ME SUKSES SHKOLLA/KURSI VEROR 2023

Para pak ditëve në Qendrën Kulturore Oblikë përfundoi me sukses shkolla/kursi veror 2023, përmes një ceremonie festive me pjesëmarrësit e nxënësve (djem dhe vajza) të moshave të ndryshme 7-14 vjeç.



Në këtë ceremonie mbylljeje të kursit veror intensiv, i organizuar nga Myftinia Shkodër, mori pjesë drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, cili falënderoi mësuesen znj. Kimete Elezi, për bashkëpunimin e saj të vyer, përkushtimin dhe punën e saj të palodhur gjatë gjithë procesit mësimor të kursit, si dhe prindërit të cilët dërguan fëmijët e tyre në këto programe me karakter edukativ dhe zbavitës.



Teologu Halluni dha edhe disa këshilla të dobishme për fëmijët, për të cilët kërkohet një bashkërendim i kujdesshëm nga të gjithë institucionet për edukimin e tyre me besim dhe moral të mirë dhe shembullor.

Kujtojmë, se gjatë shkollës/kursit verore, që filloi më 15 qershor 2023 dhe zgjati rreth 3 javë u mbajt në qendrën kulturore të Oblikë si dhe në mjediset e jashtme të xhamisë, ku janë zhvilluar orë besimi, veprimtari kulturore, piknikë, shëtitje në natyrë, lojëra kreative dhe zbavitëse, etj.







U ZHVILLUA EDICIONI I 11-TË I KONKURSIT TË MADH FETAR ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË ZONAVE ADMINISTRATIVE POSTRIBË DHE RRETHINA

Ditën e enjte paradite, më 13 korrik 2023, në xhaminë Kullaj, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi aktivitetin e edicionit të 11-të të konkursit të madh fetar me nxënësit e mejtepeve/kurseve fetare të xhamive të zonave administrative Postribë dhe Rrethina.



Aktiviteti që mblodhi nxënësit konkurrues të 15 xhamive: Dragoç, Boks, Kullaj, Mes-Myselim, Fshat i Ri, Drisht, Kalaja e Drishtit, Milan, Domën, Omaraj, Ura e Shtrenjtë, Bardhaj, Golem, Shtoj i Ri dhe Guci e Re dhe së bashku edhe me nxënësit e tjerë si pjesëmarrës,







filloi me fjalën e drejtuesit të arsimit, teologut Arben Halluni, i cili pasi i uroi mirëseardhjen nxënësve frekuentues sistematikë në mejtepet e xhamive, u foli për rëndësinë e këtij aktiviteti, që ka për qëllim të nxisë moshat e reja drejt mësimit të Kur'anit, njohurive bazë të besimit si dhe të ofrojë dhe bashkojë nxënësit në shtëpitë e Zotit, xhamitë, si vendet më të sigurta dhe garantuese për një shoqëri besimtare, të moralshme dhe të paqtë me të gjithë.

Aktiviteti i konkursit të madh fetar u shoqërua me biseda midis nxënësve si dhe me veprimtari sportive e zbavitëse në ambientet e jashtme të xhamisë Kullaj.

Pas përfundimit të konkurrimit, u zhvillua ceremonia e shpalljes së fituesve, ku juria e përbërë nga H. Lavdrim Hamja, H. Adil Cukali dhe H. Osman Osmagden nga Turkia, në bazë të pikëve të marra nga secili nxënës konkurrues, vendosën:

– Në konkursin e Kur'anit, xhuzi Amme: Çmimi i parë u fitua nga nxënësi i xhamisë Boks, Abdullah Karmaj.

– Në konkursin e Leximit të Kur'anit dhe Ilmihal: Çmimi i parë u fitua nga nxënësi i xhamisë Bardhaj, Arsila Isufi, çmimi i dytë, nga nxënësi i xhamisë Boks, Jasmin Spahia dhe çmimi i tretë, nga nxënësi i xhamisë Dragoç, Nejla Hasaj.

– Në konkursin e këndimit më të bukur të ezanit: Çmimi i parë iu dha nxënësit të xhamisë Fshati i Ri, Ebubekër Milani.

Olimpiada e Konkursit të Madh Fetar do të organizohet edhe me zona të tjera të xhamive të Shkodrës.





NË XHAMINË GANJOLLË VIJOJNË KURSET INTENSIVE VERORE "MËSOJMË DHE ARGËTOHEMI SË BASHKU"

Në fillim të muajit korrik në fshatin Ganjollë kanë filluar kurset verore intensive me moton: "Mësojmë dhe argëtohemi së bashku", me pjesëmarrjen e nxënësve të mejtepeve të xhamive Ganjollë dhe Mjedë.

Në këto kurse verore që do të zgjasin deri në fillim të shtatorit zhvillohen orë besimi, veprimtari kulturore, pikniqe, shëtitje në natyrë, lojëra kreative, zbavitëse, etj.







Ndërsa, pasditen e të enjtes, më 20 korrik 2023, drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, mori pjesë në një orë mësimi dhe argëtimi, ku pa nga afër zhvillimin e këtij programi intensiv të kurseve verore si dhe mbajti një bisedë të shkurtër, duke u fokusuar kryesisht në dhënien e disa këshilla të dobishme për nxënësit pjesëmarrës në këto aktivitete me karakter mësimor, edukativ dhe zbavitës.

Teologu Halluni falënderoi edhe mësuesin e këtyre kurseve verore, z. Erion Hasmegaj për përkushtimin dhe punën tij të palodhur në aspekt të edukimit të brezit tëri më moralin dhe frymën e vërtetë dhe të drejtë islame.

KURSI VEROR "BUZ'QESH 2023" NË XHAMINË "EBU BEKËR"

Në fillim të kësaj jave, më 24 korrik 2023, në xhaminë e madhe,"Ebu Bekër" është rikthyer Kursi Veror "Buz'qesh 2023", pas suksesit nga viti i kaluar.

Sivjet, ky kurs veror do të përqendrohet në edukimin e fëmijëve tanë me historitë e të Dërguarve të Allahut (a.s) nëpërmjet bashkëbisedimit.

Ndërkohë, nuk do të mungojnë veprimtaritë krijuese vetjake dhe në grup si dhe sigurisht lojërat zbavitëse për të përmbyllur çdo ditë me buz'qeshje.









Në hapjen e këtij kursi veror, mori pjesë teologu Arben Halluni, drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, i cili gjatë fjalës përshëndetëse, i uroj mirë se ardhjen fëmijëve/nxënësve në këtë aktivitet me karakter edukativ dhe zbavitës. Ndërkaq, teologu Halluni falënderoi bashkëpunimin e mësueseve të përkushtuara, në veçanti, teologen Zamira Bushati (Puka), për angazhimin dhe koordinimin e saj ndaj këtij programi me vlerë arsimor dhe edukativ.

MYFTIU PRITI STUDIUESIN E AFIRMUAR, Z. HAJRUDIN S. MUJA

Ditën e enjte, më 27 korrik 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, studiuesin e afirmuar krajan, me banim në ShBA, z. Hajrudin S. Muja, që shoqërohej nga H. Murat Hanife Vela, antar i Këshillit të Qendrës Islame Shqiptaro-Amerikane në Queens të Nju Jorkut, si dhe imamin e nderuar të B.Islame Ulqin, H. Astrit Nikaj.



Myftiu Sytari shprehu kënaqësinë e madhe për këtë vizitë të shënuar të z. Hajrudin S. Muja, autorit të veprave të mëdha voluminoze, plot shënime dhe referenca, si: "Në fenë e të parëve", botimet "Logos-A", Shkup, "Kisha e sherrit", botimet "Logos-A", "Kraja", "Ulqini dhe Tivari ndërmjet Krishtërimit dhe Islamit", botimet "Logos-A, etj.

Gjatë bashkëbisedimit të këndshëm, bisedat u përqendruan tek fusha e botimeve, bota e librit, historia e muslimanëve shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kontributet e tyre për ruajtjen e identitetit islam nëpërmjet ngritjes së shumë qendrave islame, si dhe përpjekja e vazhdueshme për çështjen kombëtare, mësimin e gjuhës shqipe në xhamitë e tyre, rolin e hoxhallarëve shqiptarë në këtë drejtim, etj.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu i Shkodrës, i dhuroi mikut të vyer, studiuesit Muja, disa nga botimet e tij, si dhe një kolanë të plotë të "Buletin-it" të Myftinisë Shkodër.





MYFTIU PRITI ADMINISTRATORIN E AGJENCISË "IDRIZ TRAVEL UMRA"

Ditën e hënë, më 31 korrik 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt teologun Idriz Çela, administrator i agjencisë "Idriz Travel Umra", Tiranë.

Gjatë bashkëbisedimit, Myftiu falënderoi z. Çela për kontributet e tij në shërbim të besimtarëve që shkojnë për të kryer Umren, ku një numër i madh i tyre nga qyteti i Shkodrës, janë klientë të rregullt të kësaj agjencie ndër vite.

Nga ana e tij, administratori Çela, theksoi se shërbimet ndaj vizitorëve të vendeve të shenjta janë detyrim moral dhe përgjegjësi fetare, por edhe kënaqësi shpirtërore, sidomos kur e prek kënaqësinë dhe përshpirtjen e tyre në Mekë dhe Medinën e Ndriçuar.



Ai përmendi disa raste, ku vizitorët e Qabes së Madhnueshme nga qyteti i Shkodrës, kishin pasur përjetime të mrekullueshme dhe që akoma përmenden si shembull i korrektësisë, qytetarisë dhe vlerave islame.

Gjatë takimit u diskutua për rrugët e bashkëpunimit, në shërbim të besimtarëve dhe të interesuarve për kryerjen e Umres në kushte komode dhe me shërbimet e duhura.

Myftiu garantoi se dera e Myftinisë Shkodër është e hapur për çdo mundësi që i ofrohet besimtarëve të saj, sidomos për kryerjen e këtij adhurimi të shumëdëshiruar.

MYFTIU PRITI DREJTORIN E "QATAR CHARITY"



Ditën e hënë, më 31 korrik 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, drejtorin e "Qatar Charity", z. Mahmoud Shaker.

Në qendër të vëmendjes ishin bisedimet e fundit në prag të fillimit të punimeve për xhaminë e re të lagjes Tophanë.

Pas urimit të mirëseardhjes, Myftiu e njohu z. Shaker me historikun e Islamit në Shkodër, kontributin e elitës së hoxhallarëve në shërbim të përhapjes së Thirrjes Islame, forcimin e lidhjeve me botën islame, kontributin e jashtëzakonshëm në ruajtjen e fesë islame dhe traditave të harmonisë kombëtare, edhe jashtë Shqipërisë, sidomos në periudhën e errët të komunizmit, ku shumë hoxhallarë shkodranë u kthyen në yje ndriçues, jo vetëm për komunitetet shqiptare në ShBA, Siri, etj., por edhe për shoqëritë e atyre vendeve.

U diskutua për detajet e projektit të shumëdëshiruar për xhaminë e re të Tophanës, si pjesë e strategjisë së Myftinisë Shkodër për ndërtimin e xhamive të reja, si dhe pajisjen e tyre me shtesa të domosdoshme për zhvillimin normal të jetës fetare, aktivitetit kulturor, atij social e bamirës në këto qendra të edukimit tradicional të popullatës muslimane shqiptare.

Myftiu falënderoi kontributet e Shtetit të Katarit, gjithandej nëpër botë dhe shpresoi që bashkëpunimet e frytshme në mesin e institucioneve tona fetare dhe atyre me mbështetje të këtij vendi të jenë përherë në rritje.

MYFTIU U NJOH ME RIBOTIMIN PRIVAT TË "SURJA E JASINËS", PËRKTHYE NGA SHEFQET MUKA



Paraditën e së hënës, më 31 korrik 2023, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, të nderuarin z. Adnan Muka, trashëgimtar i intelektualit të shquar musliman shkodran, z. Sheuqet Muka (1887-1967).

Me rastin e kësaj vizite, z. Adnan Muka, i dhuroi Myftiut të Shkodrës, ribotimin privat të botimit të hershëm të sures "Jasin", që zotnia e tij, pat mirësinë të risjellë për lexuesit, për shpirt të babait të tij dhe në kujtim të kontributit të tij të vyer.

Në zanafillë, z. Sheuqet Muka, e botoi këtë vepër në vitin 1929, me pseudonimin e tij të njohur, "Shkodrani".

"Surja e Jasinës, perkëthye prej Shkodranit – Shkodër, Shtypshkronja "Ora e Shkodrës", 1929", përveç parathënies së autorit, përmban përkthimin e kujtimeve të sures "Jasin" në gjuhën shqipe. Është një material shumë i vyer për njerëzit e fushës së tefsirit të Kur'anit, a studiuesve të shkencave islame në përgjithësi, si dhe një gjurmë me vlerë, në gjerdanin e veprave të panumërta të hoxhallarëve, intelektualëve dhe shkrimtarëve muslimanë të hershëm të qytetit të Shkodrës.

Gjatë bashkëbisedimit, u diskutua edhe për mundësinë e promovimit të këtij botimi të ri dhe shpërndarjen e tij për të interesuarit.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Shembulli i besimtarëve në dashuri, mëshirë dhe butësi është si shembulli i një trupi të vetëm, kur ankohet një pjesë e tij, i tërë trupi ndjen dhimbje dhe temperaturë!"

(Transmetar nga Buhariu dhe Muslimi)

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA MIRATON REZOLUTËN, QË DËNON TË GJITHA AKTET E DHUNËS NDAJ LIBRAVE TË SHENJTË

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miraton rezolutën, që dënon të gjitha aktet e dhunës ndaj Librave të Shenjtë

Të martën, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën, që dënon të gjitha aktet e dhunës ndaj Librave të Shenjtë, si shkelje e të drejtës ndërkombëtare.



"Dënojnë në mënyrën më të ashpër të gjitha aktet e dhunës ndaj personave në bazë të fesë ose besimit të tyre, si dhe çdo akt të ngjashëm, që drejtohet kundër simboleve të tyre fetare, Librave të Shenjtë, shtëpive të tyre, bizneseve, pronave, shkollave, qendrave kulturore ose objekteve të kultit."

Kjo erdhi pas djegies dhe përdhosjes së disa kopjeve të Kur'anit në vendet evropiane, duke përfshirë djegien e kopjeve të Kur'anit Famëlartë në Suedi dhe Danimarkë, në incidente që shkaktuan zemërim mbarëbotëror.

Asambleja e Përgjithshme, prej 193 anëtarësh miratoi rezolutën, të cilën Maroku e hartoi me konsensus.

Në tekstin e rezolutës thuhet, se anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme: "Dënojnë në mënyrën më të ashpër të gjitha aktet e dhunës ndaj personave në bazë të fesë ose besimit të tyre, si dhe çdo akt të ngjashëm, që drejtohet kundër simboleve të tyre fetare, Librave të Shenjtë, shtëpive të tyre, bizneseve, pronave, shkollave, qendrave kulturore ose objekteve të kultit."

Rezoluta kërkon që sulmet, të cilat kanë për qëllim Kur'anin të dënohen, duke i konsideruar ato si "akte të urrejtjes fetare".

Më 12 korrik 2023, Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (me seli në Gjenevë) dënoi aktet e përdhosjes së Kur'anit Famëlartë në fund të qershorit të kaluar në Suedi, pavarësisht se vendet perëndimore votuan në këtë drejtim kundër rezolutës së propozuar të kështillit.

Rezoluta bën thirrje për dënimin e sulmeve që kanë për qëllim Kur'anin, duke i përshkruar ato si "akte të urrejtjes fetare".

Tensionet u shtuan midis Stokholmit dhe vendeve islame për shkak të djegies së faqeve të Kur'anit nga një refugjat irakian në Suedi muajin e kaluar.

Në incidentin e njëjtë të fundit, të enjten refugjati Silvan Momica sulmoi përsëri Kur'anin, por nuk e dogji atë, duke shkaktuar reagime të reja dënimi në mbarë botën myslimane.

Ez'heri Sherif dënoi incidentin e së enjtes në një deklaratë, duke dënuar "provokimet e përsëritura të ushtruara nga autoritetet suedeze kundër shenjtërive tona islame nën moton e rremë të lirisë së shprehjes".

(www.aljazeeramubasher.net)

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

"Gëzohuni, gëzohuni! A nuk jeni që dëshmoni se nuk ka zot tjetër, përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut?"

Thanë: Po.


Tha: "Ky Kur'an, njëri skaj i tij është në dorën e Allahut dhe skaji tjetër në dorën tuaj.

Kapuni për të, sepse s'keni për të humbur kurrë dhe nuk keni për t'u shkatërruar asnjëherë pas tij!"

(Hadith sahih, transmetuar nga Ibn Hibani dhe të tjerë)

MYFTINIA SHKODËR

PASTËRTIA
ËSHTË GJYSMA E BESIMIT



I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: **"Pastërtia është gjysma e besimit! Elhamdulilahi mbush peshoret!**
Subhanallahi vel-hamdulilahi mbush çfarë ka mes qiejve dhe tokës!
Namazi është dritë; Sadakaja është argument; Durimi është shkëlqim;
Kur'ani është argument për ty ose kundër teje;
Secili njeri gdhihet duke e shitur veten e tij, ose e shpëton ose e humbet"!

- (Transmetuar nga Muslimi)

RUAJE PASTËRTINË

RUAJE HIGJIENËN

JETO PASTËR!

MË SKANO

MYFTINIA SHKODËR

www.myftinia-shkoder.org

@Myftiniashkoder1990

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek